



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **17 prill 2026, (e premte)**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**.

Kryesuesi: Fillimisht, besoj që materialin e keni pranuar! Atëherë, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar komunës, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, kabinetin e kryetarit, sekretarinë e kuvendit.

E hapim mbledhjen e **katërt (4)** për këtë vit kalendarik. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P- O-71510057-106-0-2-0, P- O-71510057-106-0-3-0, P- O-71510057-106-0-4-0, P-O-71510057-106-0-8-0, P- O-71510057-106-0-9-0 dhe P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec;
3. Shqyrtimi propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P, O-71510057-106-0-2-0, P- O-71510057-106-0-3-0, P- O-71510057-106-0-4-0, P- O-71510057-106-0-8-0, P- O-71510057-106-0-9-0 dhe P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec;
4. Shqyrtimi i raportit financiar janar-mars 2026;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shërbime Publike;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Mbrojtje, Shpëtim dhe Emergjencë;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush ka diçka rreth rendit të ditës? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P- O-71510057-106-0-2-0, P- O-71510057-106-0-3-0, P- O-71510057-106-0-4-0, P-O-71510057-106-0-8-0, P- O-71510057-106-0-9-0 dhe P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec:

Altin Zhuniqi: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, kolegë drejtorë. Para jush e keni propozimin lidhur me lokalet e palestrës që janë dhënë në shfrytëzim afatshkurtër. Bëhet fjalë për 6 lokale dhe 3 prej tyre janë: Casa, Fole dhe Bon bon, të cilëve u skadon kontrata në fund të muajit maj dhe 3 lokale tjera janë te pjesa përball sheshit që janë ende të pashfrytëzuara. Lokali i parë 106-0-2-0, 58 m². Lokali i dytë 106-0-3-0, 63m². Lokali i tretë 106-0-4-0, 63m². lokali i katërt 106-0-8-0, me sipërfaqe 60m². Lokali i pestë 106-0-9-0, me sipërfaqe 60m² dhe lokali i gjashtë 106-0-10-0, me sipërfaqe 60m². Afati kohor i dhënies në shfrytëzim është afatshkurtër dhe është 8 vjet.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për anëtarët e KPF-së dhe për drejtorët e drejtorive. Për në seancën e rregullt, kërkoj nga drejtori një informatë në lidhje me çmimet e lokaleve të palestrës që janë dhënë në shfrytëzim, si dhe përfituesit e tyre.

Defrim Kafexhiu: Drejtor, për dallim prej atyre lokaleve që janë dhënë, pse tani afati është zgjatuar për tri vjet, nga 5 në 8? Përsëri po lidhem me propozimin e idesë së rregullores. Çmimi që përcaktohet me rregullore komunale është shumë i ulët dhe nëse e japim për 8 vjet, besoj që komuna nuk përfiton mjaftueshëm në rastin e këtyre pronave me vlerë të madhe, më të madhe në komunë. Ne, duhet ta shtyejmë këtë proces deri sa të hartohet një rregullore e re për sheshin qendror, sepse nuk ka qira 300 euro përreth sheshit dhe lokalet nga ana e sheshit tani po dalin edhe më lirë. Një pyetje tjetër: Si janë të rregulluara me rregulloren aktuale terracat e lokaleve? Gjithashtu, lokali numër 6 që tash po do të jepet në shfrytëzim, ka qenë në procedurë të ankandit dhe në mandatin e kaluar ka përfunduar procedura. Unë personalisht jam interesuar për atë proces të ankandit. Në këtë rast, aty dikush e ka fituar ankandin, por nuk ka arritur ta nënshkruajë kontratën. A është në rregull ligjërisht dhe proceduralisht komuna si institucion, që përsëri t'i vazhdojë procedurat e ankandit edhe pse nuk është përfunduar nënshkrimi i kontratës? Pra, puna ka mbetur pezull derisa komuna përsëri ka vendosur që t'i zhvilloj procedurat e ankandit. A mund të pësojë komuna, në rast të një kontesti gjyqësor? Ku është interesi i komunës në këtë rast, sepse ka 1 vit që nuk është nënshkruar kontrata dhe nëse nuk gaboj, raporti i komisionit është në mars të vitit 2025?! Deri tani, komuna nuk ka përfituar qira dhe as fituesi nuk e ka gëzuar pronën. Si ka mbetur puna e kësaj prone?

Berat Duraku: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për drejtorat, nënkryetarin dhe kolegët e KPF-së. Pa dashur t'i replikoj kolegut parafolës, ka disa herë që ne po merremi me çmimin e rregullores, të gjithë do t'i nënshtrohen një ankandi dhe sipas të gjitha gjasave, komisioni si kriter bazë do ta ketë çmimin më të lartë.

Defrim Kafexhiu: Në kërkesën që e bëri Lirigzoni më herët, këto informata mund t'i shohim (pavarësisht ankandit) se në çfarë çmime i kanë marrë lokalet që janë aktive në sheshin qendror. Ne jemi rregull që t'i nënshtrohemi procedurës së ankandit, por rregullorja nuk bën t'i trajtojë pronat njëjtë, si në shesh, si në periferi. Nëse ne e imlementojmë një rregullore të re për funksionalizimin e sheshit, besoj që rregullohet më mirë, sepse mund të përfshihet çmimi, mirëmbajtja dhe çka lejohet e çka nuk lejohet të shfrytëzohet.

Kryesuesi: Për t'u filluar si proces, për një rregullore na duhet minimalisht 4-5 muaj, rrjedhimisht dëgjimi publik, pëlqimi, kalimi në kuvend, zbatimi, ligjshmëria dhe hyrja në fuqi. Sa i përket informatës rreth përfituesëve të lokaleve, nuk e di nëse kemi të drejt. Besoj që drejtori i ka regjistruar këto kërkesa. Gjithashtu, ne e kemi edhe rregulloren e tatimit në pronë, që tatimi paguhet sipas vendit dhe dallon në periferi e në zona të tjera, nëse nuk gaboj ndahet në 4 zona.

Altin Zhuniqi: Në dëgjimin publik për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa nuk morët pjesë asnjëri prej juve dhe pikërisht aty e kemi bërë plotësim-ndryshimin te pjesa që prej 2 euro është bërë 3 euro, për lokalet afariste. Arsyeja se pse janë bërë për 8 vite, qëndron te puna e investimeve të lokaleve. Në këtë rast i skadon, Casës, Fole-s, Bonbon-it, të cilët kanë investuar shumë dhe tani është pak e "padrejtë" që t'ia merr dikush tjetër.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A ka diskutim tjetër?... Nëse jo, po e vendosin në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me një votë abstenim, miratohet pika e dytë.

3. Shqyrtimi propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P, O-71510057-106-0-2-0, P- O-71510057-106-0-3-0, P- O-71510057-106-0-4-0, P- O-71510057-106-0-8-0, P- O-71510057-106-0-9-0 dhe P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec:

Kryesuesi: Vendimin e keni para vetes dhe në kuvend na mbetet që t'i zgjedhim anëtarët e komisionit.

Defrim Kafexhiu: Sipas vendimit që po e marrim, a do të lejohet që një personi fizik apo juridik që këtë pronë t'ia jep dikujt tjetër, a është e specifikuar në vendim që ndalohej?

Lirigzon Kastrati: Njëjtë edhe unë po e përmendi këtë çështje. A ka ndodhur që prona e komunës që e ka marrë dikush në shfrytëzim të bartet te një person tjetër?

Kryesuesi: Këto gjëra precizohen dhe sqarohen në kontratë, bashkë me përfituesin e pronës. Po e vendosi në votim pikën e tretë të rendit të ditës. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me një abstenim dhe të tjerat pro, miratohet pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i raportit financiar janar-mars 2026:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, të nderuar anëtarë të KPF-së. Raporti financiar 3-mujor janar-mars, për dallim prej raporteve të tjera është më i shkurtër dhe përbëhet nga dy pjesë: pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit. Në raport mungon pjesa e kontratave të lidhura, sepse deri në këtë periudhë nuk kemi ndonjë kontratë të lidhur. Besoj që në raportin 6-mujor do të ketë kontrata të lidhura, gjithashtu obligime financiare dhe kontraktuale. Të hyrat, në total për këtë periudhë janë: 272.258 dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, atëherë kemi një rezultat negativ prej 57.955, edhe pse ju në raport e keni gabim teknik prej 171.000. E kemi edhe një tabelar tjetër, ku bëhet një krahasim i të hyrave ndërvite, duke filluar nga viti 2020-2026 dhe shihet që viti 2026 është shumë më i ulët në krahasim me vitet e tjera. Kjo gjendje kryesisht është kështu, sepse faturat e tatimit në pronë janë procesuar në fillim të muajit prill dhe në periudhën aktuale procesi po shkon shumë mirë. Në faqen nr. 4 janë të hyrat e rregullta, bashkë me gjobot e gjykatave dhe të trafikut, këto të fundit nuk i kemi në raport se sa kanë qenë për këtë 3-mujor. Rezultati në krahasim me vitin e kaluar është minus 149.000. Shpresoj që shumë shpejt do ta kemi raportin dhe besoj që do të kemi një inkasim të mirë edhe nga gjobot e gjykatave dhe të trafikut. Në faqen nr. 7 e kemi shpenzimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, duke u bazuar në programet aktuale. Atëherë, përqindja e shpenzimit të buxhetit është 36.98%. Sa për për dijeninë tuaj, te investimet kapitale është 57.52% dhe realisht nuk e kemi ekzekutuar asnjë cent, të gjitha këto janë mjete të tërhequra nga thesari, duke e zbatuar kontratën kolektive në arsim. Pra, 2.846.000€ janë tërhequr vetëm te pjesa e investimeve kapitale. Sipas kërkesë së Lirigzonit, deri më tani në total nga thesari për kontratën kolektive dhe një pjesë nga përmbaruesit për operatorët ekonomikë, janë tërhequr 2.910.000€. Vetëm për kontratën kolektive janë 2.124.000 dhe për operatorët 726.000 dhe nga përfituesit e tjerë janë 58.000.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, drejtor! Te faqja 5, realizimi në 2025 te të hyrat është 118.000, a është për komplet vitin kalendarik, apo për periudhën janar-mars?

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shërbime Publike:

Kryesuesi: Ka qenë kërkesë e të gjithë neve, por në veçanti e Lirigzonit. Formimi i komiteteve është një lloj kontrolli ndaj punës së ekzekutivit, në mënyrë që puna të kryhet më mirë. Anëtarët e këtij komisioni do të përcaktohen në seancën e rregullt të kuvendit. Kush është "për"?... A kemi kundër?... Unanimisht miratohet pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Mbrojtje, Shpëtim dhe Emergjencë:

Kryesuesi: Është një komitet tjetër që do të formohet dhe njëjtë edhe këtu emrat do të përcaktohen në kuvend. Kush është "për"?... A kemi kundër?... Unanimisht miratohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Të ndryshme:

Kryesuesi: A ka dikush diçka rreth kësaj pike fundit të rendit të ditës? Nëse jo, atëherë ju njoftoj se për mbledhjen e rregullt të kuvendit do t'i keni edhe këto pika shtesë: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Taksa Komunale; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimit të vendimit 01/112 për dhënie në shfrytëzim të pronës kompanisë Best Friends me seli në Prishtinë; 3. Vendim për miratimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe; 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt rregullores për procedurat dhe kriteret e ndërtimit dhe 5. Formimi i komisionit për ndarje të banesave të banimit social. Nëse eventualisht dikush nuk ka diçka për të thënë, ne po e mbyllim këtë takim që të takohemi në seancën e rregullt të kuvendit.

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi



KRYESUESI


Fatmir Iska